

Botuar me shkurtime dt 18.09.2010 ne gazeten Shekulli

LETËR PA ZARF , APOSTAFAT PËR DEPUTETËT E PDU SHPËTIM IDRIZI DHE DASHAMIR TAHIRI

Nga Rrapo Hajredin Danushi *

Praktikisht Shqipëria drejtohet nga klane ose banda që synojnë si e si të pasurohen. Këtë e kemi argumentuar në një shkrim të botuar në disa nga gazetatat e datës 25.8.2010 ku lidhur me shkeljen e të drejtës së pronës kemi thënë se : ... Ndofta të parët që prokuroria do të duhet te verë para përgjegjësish penale janë shkelësit e kushtetutës d.m.th. qeveritarët. Kanë kaluar plot 19 vjet akoma nuk keni kthyer tek i zoti përfshi edhe ato prona që vazhdojnë të jenë në po atë gjendje që ishin në kohën që i shtetëzoi Enver Hoxha. Ju pasi keni bërë një nen që i ndalon pronarët ti drejtohen gjykatës për pronat pa marrë më parë një përgjigje nga kryetari i Agjensisë Elvis Çefa, propozuat nëpërmjet Enkelejd Alibeajt një ligj tjetër që të zgjatet edhe më shumë koha e qëndrimit të pronarëve në pritje për vendimin nga Agjensia. Ju keni miratuar një ligj të vaçantë për legalizimin e veprimeve të paligjshme (pushtime trojesh ndërtime pa leje) dhe 27 zyra ALUIZNI kurse për kthimin tek i zoti të pronës së trashëguar keni vetëm 1 zyrë, që praktikisht mban peng pronarët. Kjo imponon korrupsionin për të cilin jeni përgjegjës. Ky korrupsion infekton këdo dhe ju bëni çmos që dhe reporterët e Bashkimit Evropian të bëjnë një hap majtas e një tjetër djathas. Ndërkombëtarët nuk e kanë kuptuar se Politika e pas 1991 ku ju luani rrolin kryesor nuk respekton të drejtat e njeriut por i është nënshtruar mafies së trojeve dhe kjo ka zhvilluar korupsionin. Po në këtë shkrim që ja kemi drejtuar kryeministrit Sali Berisha, por kuptohet edhe të gjithë politikanëve që i duan të mirën Shqipërisë kemi thënë “ Zoti Kryeministër, pa dashur të përsëris ato që ju kam thënë vite më parë si dhe së fundmi në shkrimin e botuar datë 23.07.2010 , shkrim që me siguri e keni lexuar, në pamundësi për të ju patur ballë për ballë në debat publik, ju them se me përjashtim të zonave veriore ku prona e grabitur u kthye tek i zoti, për anarkinë e pronës që është krijuar pas vitit 1991, ju jeni përgjegjësi kryesor dhe pas jush vjen Fatos Nano. Këtë çmënduri me pronën po e paguan populli. Ju prej 1991 deri 1998 keni shkelur Dispozitat Kryesore Kushtetuese dhe liritë dhe të drejtat e njeriut dhe sajuat ligje antidemokratike dhe antikushtetuese dhe institucione që pengojnë kthimin e pronës tek i zoti. Të njëjtën linjë antipronar ju po vazhdoni, duke shkekur Kushtetutën e miratuar në 1998. Sot veprimtaria e shtetit shkel detyrimet kushtetuese që ju ka përmendur me shumë të drejtë Presidenti i Reublikës zoti Bamir Topi , në arsyetimin me të cilin ktheu ligjin e propozuar nga ish ministri i Drejtësisë

Enkelejd Alibeaj.” Unë kam bindjen se të gjithë deputetët i analizojnë dhe reflektojnë për këto shkrime pavarësisht se cila gazetë i boton ato

Radiografia e pronave të gllabëruara nga politikanët e PD dhe PS pas vitit 1991 për të cilën flet herë pas here kryeministri Sali Berisha janë vetëm deklarata propagandistike. Mundet që politikanët e Partisë Socialiste të kenë vjedhur më shumë se ata të Partisë Demokratike. Këto deklarata janë si pema pa kokrra, që nuk mashtrojnë më pronarët e shpronësuar që kanë 19 vjet që presin kthimin e pronave të trashëguara. Por këto deklarata nuk duhet të mashtrojnë më tej Komisionerët e KE (aktualisht zotin Stefan Fyle), ambasadorët e vendeve demokratike dhe ata të KE, BE, OSBE, të cilët tashmë duhet ta kenë kuptuar se e vetmja zgjidhje mbetet kushtëzimi që Qeveria të kryej reformën e pronës, duke e përcaktuar këtë si detyrim emergjent të shtetit. Duke qenëse të dy krahët e politikës janë të interesuar për të mos bërë zgjidhjen e këtij problemi, zgjidhja kërkon vëmendjen dhe asistencën e vaçantë të faktorit ndërkombëtar. Ne kemi kërkuar solidarizim dhe mbështetje nga faktori ndërkombëtar, duke përcaktuar dhe afatin kohor për përfundimin e kthimit fizik dhe shpalljes së pavlefshmërisë për të gjitha tjetërsimet e bëra pas vitit 1991, për pronat ku shteti nuk disponon dokumenta pronësie në përputhje me nenin 41 të Kushtetutës. Në këtë zgjidhje përfaqësuesit e shtetit duhet të kenë përballë Shoqatën “Pronësi me Drejtësi” dhe shoqatën “Bregdeti” që përfaqësojmë palën e dëmtuar të pronarëve të ligjshëm të shpronësuar nga komunizmi dhe të shpronësuar përsëri ose të vjedhur nga postkomunizmi

Data 16 shtator 2010 shëni një ngjarje të turpshme nga deputetët. Ata të mbledhur në séancë planate për rishqyrtimin e ligjit për "Shtesa dhe Ndryshime në ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës", nuk pranuan vërejtjet e Presidentit të Republikës Bamir Topi që ligji për pronat të respektojë të drejtën e pronës dhe të përputhet me nenin 41 dhe 81 të Kushtetutës. Gjatë votimit të parë deputetët e Partisë për Drejtësi dhe Unitet PDU, Dashamir Tahiri dhe Shpëtim Idrizi si dhe deputetët Paulin Sterkaj dhe Fatmir Mediu, votuan kundra dhe përkrahën kërkesën e Presidentit të Republikës, “i çuditshëm” ishte manipulimi i pushimit të séancës dhe përsëritjes së votimit. Ishte i turpshëm ndryshimi i drejtimit nga këta katër deputetë . Ndofta këta deputetë janë dorovitur me kusht që të bëjnë ndryshimin e votës tyre, por ndofta i kanë komanduar të votojnë ndryshe duke ju rikujtuar zullumet por këtë e di vetëm ndërgjegjja e tyre. Rezultati ishte se këto veprime rëzuan me 72 vota pro dekretin e Presidentit Bamir Topi, për kthimin si antikushtetues të ndryshimeve në ligjin për "Kthimin dhe Kompensimin e Pronave" dhe në të njëjtën kohë këta deputetë të popullit na kërkojnë që t'i japin të drejtën kryetarit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të shqyrtoje ankesat dhe dosjet e pronarëve, pa i përcaktuar asnjë afat kohor, tejkalimi i të cilit të lerë të lirë rugën gjyqësore. Atë që kërkon projektligji i deputetit Alibeaj, është krejt e panevojshme pasi këtë të drejtë praktikisht e ka Kontrolli i Shtetit, çdo prefekt dhe prokurori.

Turp , për të gjithë politikanët që ju kundërvunë kërkesës së drejtë të Presidentit të Republicës dhe mbrojnë anarkinë e pronës , turp , për politikanët që vazhdojnë ta mbrojnë ligjin antikombëtar 7501 që praktikisht i shërben helenizimit të Shqipërisë së jugut por turp turp, turp dhe shumë herë turp që do ti shoqërojë për gjithë jetën dy deputetëve të PDU Shpetim Idrizi dhe Dashamir Tahiri. Ata , janë betuar se do zbatojnë Kushtetutën dhe të drejtat e njeriut si dhe kanë premtuar se me mjete ligjore dhe diplomatike do kërkojnë zgjidhjen e çështjes pronësore të shqiptareve në Greqi. Por praktikisht kur erdhi momenti për të votuar, ata mbrojtën këtë dopio standard për pronat e shtetasve në Shqipëri. Vota tyre ishte thikë pas shpine për demokracinë.

*Kryetar i Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi”